

VENDIM
Nr. 728, datë 28.8.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TE MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME
TË PASURISË “OFIÇINA E AUTOMJETEVE, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14 e 15, shkronja “c” të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2003 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të pasurisë “Ofiçina e Automjeteve, Tiranë”, me sipërfaqe prej 14 502 m², nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te Ministria e Punëve të Jashtme, sipas planvendosjes së objektit dhe dokumentacionit ligjor të pronës, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Heqjen nga lista e inventarit të pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që i bashkëlidhet vendimit nr. 378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e së drejtës të përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të pronës “Ofiçina e Automjeteve, Tiranë”, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha